

# **Politikani i Ri**

## **Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike**

# Politikani i Ri

## Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**NATIONAL  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE**  
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

Lejohet prezantimi, kopjimi dhe shpërndarja e librit në tërësi apo në pjesë, me kusht që: (a) materialet të përdoren duke i njohur USAID-it dhe NDI-së autorësinë e botimit, (b) ky libër do të shërbejë vetëm për përdorim informativ, jo-tregtar dhe personal, (c) të mos bëhen modifikime të këtij libri.

Ky libër u mundësua përmes mbështetjes së ofruar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën Marrëveshjen Bashkëpunuese (Cooperative Agreement) Nr. 182-A-00-04-00104-00 me NDI. Opinionet e shprehura në këtë botim janë të vetë autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID.

Botuar nga Shtëpia Botuese “PEGI”

Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Filipeu Nr.2, Tiranë

Tel: +04 374947

Fax: +04 374947

Përgatitur nga Dan Redford, Najada Tafili, Elton Stefani, Blerina Karagjozi

Faqosja: Erald Velmishi

ISBN: 99943-705-3-7



# Përmbajtja

• Parathënie	VI
• Dy fjalë për kontribuesit	VIII
1. Roli i qytetarëve në zgjedhje, çështje e individit dhe e shoqërisë <i>Gentiana Dorezi</i>	1
2. Koha e një proporcionali të pastër dhe pragu më të lartë <i>Aristir Lumezi</i>	5
3. Votimi elektronik, kaq larg dhe njëkohësisht kaq afër? <i>Elton Beqiraj</i>	9
4. Zgjedhjet si një nga mekanizmat kryesorë që prodhojnë demokraci <i>Elton Beqiraj</i>	15
5. Meritokracia... të jesh a të mos jesh! <i>Rezear Kolaj</i>	19
6. Sistemet zgjedhore <i>Nriçim Hasanaj</i>	23
7. Çfarë nënkuptojnë zgjedhjet <i>Fatmir Roshi</i>	27
8. Zgjedhjet dhe Shqipëria <i>Sokol Terihati</i>	29
9. Votimi i njerëzve me paaftësi fizike <i>Suzana Celami</i>	31
10. Probleme të sistemit zgjedhor <i>Fran Tusha</i>	35
11. Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)	38

# Parathënie

National Democratic Institute for International Affairs (NDI) nëpërmjet Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike, ndihmon në përgatitjen e 75 pjesëmarrësve të zgjedhur nga 10 parti të ndryshme politike.

NDI e vlerëson këtë fazë të Programit të Partive Politike dhe Proceseve Zgjedhore si një etapë të rëndësishme në investimin për të ndihmuar infrastrukturën e partive politike në Shqipëri.

Në vazhden e përmbushjes së programit të trainimit, Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike, mundëson realizimin e botimit të fletores “Politikani i Ri”. Në këtë program të ri, është menduar që ky botim të ketë një pamje të ndryshme nga e mëparshmja, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë.

Në këtë mënyrë, synohet që të realizohet një botim i një niveli tjetër, i cili do të paraqesë jo vetëm mendime dhe opinione, por dhe një standard ndryshe të shprehjes së një brezi të ri politikanësh, të cilët me përfshirjen e tyre në jetën politike të vendit, hap pas hapi do të tregojnë dhe vënë në jetë, dijet dhe aftësitë e fituara nga modeli i zgjedhur perëndimor.

Duke qënë përpara një ngjarjeje tepër të rëndësishme në jetën politike të vendit, siç janë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të kësaj vere, është menduar që numri i rradhës t'i kushtohet pikërisht procesit të zgjedhjeve. Të gjithë jemi dëshmitarë të klimës së krijuar në vend, ku dëshira për të pasur një proces të lirë dhe të ndershëm zgjedhjesh, shoqërohet me përgjegjësinë e secilit për t'u bërë pjesë e procesit.

Ndryshe nga më parë, në këtë fletore do të përfshihen shkrime

të plota, të cilat janë analiza të sistemit zgjedhor aktual në vend, të problemeve të ndryshme që janë paraqitur në zgjedhjet e mëparshme, duke dhënë herë pas here edhe sugjerime për shmangien dhe zgjidhjen e tyre.

Në realizimin e këtij numri, kanë dhënë kontributin e tyre pjesëmarrës të disa partive të spektrit politik shqiptar. Një rol të veçantë dhe përcaktues në procesin zgjedhor, kanë padyshim qytetarët, të cilët duke ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, japin ndihmesën e tyre në përzgjedhjen e ligjvënësve të rinj.

Në këto shkrime mund të gjeni mendime në lidhje me llojin e sistemit zgjedhor ku ngrihen pyetje dhe ide për zgjedhjen midis sistemit mazhoritar, proporcional apo të përzier; mënyrës së votimit, ku një sugjerim me vlerë mund të jetë edhe votimit elektronik; mënyrës së përzgjedhjes në listën e kandidatit për deputet, sipas kriterëve meritokratike apo dilemave të një njeriu të ndershëm për të kandiduar ose jo; nuk është harruar në këtë botim as votimi i personave me aftësi të kufizuara, të cilët fatkeqësisht ende janë të privuar nga një e drejtë themelore e çdo njeriu, e drejta për të votuar.

Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të vetë autorëve dhe nuk përfaqësojnë këndvështrimet e NDI.

Në këtë botim ne shpresojmë që të kemi mundësuar paraqitjen e një fryme të re në vazhden e botimeve në fushën e politikës.

Dan Redford  
Këshilltar i Lartë për Partitë Politike dhe Proceset Zgjedhore  
Elton Stefani  
Oficer Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike  
Najada Tafili  
Oficere Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike  
Blerina Karagjozi  
Asistente Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike

NDI/Shqipëri  
Maj 2005  
Tiranë

# Dy fjalë për kontribuesit



**Gentiana Dorezi**

Departamenti Ligjor pranë  
Partisë Demokratike

**Aristir Lumezi**

Përgjegjës i Zyrës së Sekretarit të  
Përgjithshëm në Partinë Socialiste



**Elton Beqiraj**

Kryetar i LRI, në Durrës  
Lëvizja Socialiste për Integrim



**Armand Bora**

Anëtar i Komitetit të Orientimit të  
Politikave në Partinë Demokratike





**Rezear Kolaj**

Anëtar i Komisionit të Bujqësisë  
në Partinë Socialiste

**Nriçim Hasanaj**

Nënkryetar i nëndegës  
së Partisë Demokratike, Tiranë



**Fatmir Roshi**

Anëtar i Kryesisë së Tiranës,  
Partia Balli Kombëtar Demokrat

**Sokol Terihati**

Drejtor i Marrëdhënieve me Median në  
Partinë Republikane



**Suzana Celami**

Anëtare e Kryesisë së Gruas  
në Partinë Socialiste

**Fran Tusha**

Kryetar i Partisë Demokristiane, Mirditë





# 1. Roli i qytetarëve në zgjedhje, çështje e individit dhe e shoqërisë

*Gentiana Dorezi*

Mesviti po afron. Së bashku me temperaturat e larta, ky mesvit tipik kryeqytetas pret të “shijojë”, përveç çeljes së fushatës zgjedhore dhe djersitjen e çdo konkurenti kandidat për vendin e deputetit në kuvend, por ndërsa djersitja e kandidatëve është një çështje që më së shumti duhet të menaxhohet në mënyrë të organizuar nga struktura partiake që synojnë në këtë prag fushate fitimin e mazhorancës ose vende të sigurta për aleanca potenciale, janë qytetarët shqiptarë që në mënyrën e tyre krejt individuale kësaj here duhet të respektojnë votën dhe vlerën e saj. Në kuptimin e respektit për votën gjykoj që është roli i “qytetarëve”, gjatë këtij procesi zgjedhor që duhet të bëjë dallimin nga proceset zgjedhore të shkuara.

Sot, mbas më shumë se 13 vjet zgjedhjesh të aspiruara si të lira, çdo qytetar shqiptar që jeton brenda në metropol ose zona në zhvillim, duhet të jetë më i vetëdijshëm se kurrë, për rolin dhe misionin e tij politik gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.

Sot, pas 13 vjetësh të gjithë qytetarët shqiptarë duhet të jenë më të ndërgjegjshëm dhe më kërkues ndaj forcës politike që konkurron për t’u zgjedhur, duke i bërë së pari pyetjen vetes, nëse kjo trupë i konsideron ata si “qytetarë”, për nga roli dhe fuqia, apo thjesht “popull”, që i ndjek dhe i përkrah, por nuk përzihet në

punët e qeverisjes.

Megjithë mirëkuptimin dhe angazhimin e trupës politike për t'i konsideruar zgjedhësit "qytetarë", shtetasit shqiptarë që gëzojnë të drejtën e votës në mënyrë krejt të ndërgjegjshme kësaj here, duhet të kuptojnë dhe të vlerësojnë gjithësecili se nëse ata nuk sillen dhe nuk marrin mbi vete përgjegjësinë për t'u konsideruar si faktori themelorë, për të cilin iniciohet politikëbërja nuk munden kurrësesi të aspirojnë përmirësimin e jetësës së tyre.

Të quhesh zgjedhës "qytetar", të ushtrosh këtë të drejtë në potencë është dhe duhet kuptuar prej secilit prej shtetasve si i vetmi mekanizëm efektiv që individët e lirë, të organizuar në një formë qeverisje pluraliste çdo 3/4 vjet, synojnë me këtë mjet, për të gjithë bashkësinë ku jetojnë në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë secili për vete, të realizojë mundësinë për të përmirësuar më shumë nivelin e jetës.

Fushata zgjedhore duhet të konsiderohet nga çdo zgjedhës si një shans më tepër për të dhe të dashurit e tij; si një mundësi ku familja e tij e ngushtë të përmirësojë nivelin aktual të jetesës, të përfitojë nga politika të caktuara shtetërore; ku individit të ndjehet më i sigurtë në vendin e punës ose në biznesin që ushtron; ku sistemi shëndetësor të reformohet dhe përfitimet të jenë konkrete; ku fëmija të arsimohet në institucione shkollore të denja për nga emri dhe standaret e mësimdhënies; ku shteti të bëjë një politikë më dinjitoze me fqinjët dhe të kuptojë se nuk mund të abuzojë me termin "partnerë" dhe "miq"; ku individit dhe familja të mund të ushtrojnë, së bashku ose veçmas, më me potencë se katër vitet që shkuan, të drejta të deklaruara dhe të pranuar në mënyrë universale nga të gjithë për të lëvizuar dhe "parë botën", pa patur frikën se politikat konsullore të ndonjë shteti do t'i konsiderojë, ata dhe familjen, si "persona me risk" për t'u kthyer në vend.

Në fund të fundit të quhesh zgjedhës duhet të kuptosh se ti, individit, dhe qeverisja e katër viteve në vijim synoni të jeni partnerë me njëri-tjerin në politikat që do aplikohen në vijimësi ose të jeni në oponencë apo skeptik ndaj këtyre politikave.

Qytetarët shqiptarë në këtë fushatë duhet t'i tregojnë politikanëve se janë në korrent të situatës politike dhe ekonomike në vend. Se janë më të ndërgjëgjshëm se asnjëherë tjetër për të ushtruar të drejtën e votës si “qytetarë” dhe jo si “zgjedhës”.

Se, gjatë këtij raundi të lodhshëm llogaridhënie dhe premtimesh kandidatët pozitarë apo opozitarë, përpara çdo zgjedhësi të duhet të jenë të gatshëm të japin së pari, llogari për ç'kanë bërë dhe së dyti t'i përgjigjen pa demagogji “pyetjes” se ç'mund të bëjnë, duke e konsideruar komunikimin me çdo zgjedhës potencial, si prioritet të partisë në përgjithësi.

Të jesh zgjedhës, duhet që çdo ditë të ndërgjegjësohesh për të qënë “qytetar”, duke mos ngurruar, megjithëse është përgjegjësi e shtetit të sigurojë këtë të drejtë; të verifikosh nëse je i regjistruar si votues në listat e votimit; të kërkosh të regjistrohesh nëse të kanë harruar gabimisht sipas “shtetit” ose me kast sipas teje; të ndjekësh qëndrimet e partive politike për politika që ti ke interes dhe janë prioritare për fatet e tua; të jesh i pranishëm nëse në zonën tënde zhvillohen takime me kandidatët, dhe në mënyrë të veçantë takime ku merr pjesë dhe kandidati që t'i ke votuar herën që shkoi; të pyesësh pa druajtje eksponentë të partisë tënde ose partisë që t'i mendon se do të votosh në lidhje me qëndrime të paqarta të politikës së saj ose të kandidatit; të vlerësosh si individ “personalitetin”, që konkurren në zonën tënde; të jesh më aktiv me njerëzit që të rrethojnë për t'i nxitur për të marrë pjesë në votime.

Dhe të gjitha këto me qëllim që në zgjedhjet e sivjetme, djersë të ftohta të rrjedhin nga çdo ball politikani, i cili gjatë mandatit katër vjeçar nuk ka pasur në axhendën e tij si prioritare përmirësimin e nivelit ekonomik tëndin personal ose me neglizhencën e tij apo keqdashjen ka ndikuar, që ti vetë, fëmijët, familjarët ose njerëzit e dashur për ty, të jenë më skeptik për të ardhmen.

Të jesh qytetar, në këtë “mesviti kryeqytetas” dhe mesvite të tjerë, do të thotë të kesh komoditetin që në çdo fushatë zgjedhësh t'i përziësh me masë dhe në mënyrën tënde subjektive të drejtën

*Roli i qytetarëve në zgjedhje, çështje e individit dhe e shoqërisë*

që ti ke për të bërë politike dhe të të gjykuarit sesi janë bërë ato.

Mesviti i tashëm kryeqytetas duhet të ketë më shumë qytetarë, që sfidojnë të menduarit “steriotip” të politikanëve për zgjedhësit-popull.

## 2. Koha e një proporcionali të pastër dhe pragu më të lartë

*Aristir Lumezi*

Zgjedhja e sistemit zgjedhor, është një nga vendimet më të rëndësishme institucionale për çdo demokraci. Historia na tregon se në përgjithësi sistemet zgjedhore nuk zgjidhen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të lirë. Shpesh ato përcaktohen nga kombinime të pazakonta rrethanash apo të ndryshimeve historike. Ndërsa në rastin e demokracive të reja, sistemet zgjedhore zgjidhen me qëllim, në qendër të të cilit qëndron zgjedhja e parlamentit.

Historia shqiptare e pas viteve '90, është një histori pluripartiake, e cila do të shuante etjen e erës demokratike me krijimin e një numri të madh partish politike. Kjo tendencë kishte shpjegimin e saj historik, sepse vinte si një antipod i sistemit njëpartiak 50-vjeçar dhe mori përmasa të pakufizuara deri në abuzive. Ky plotësim i vakumit partiak në jetën shqiptare, rrjedhimisht solli dhe përcaktimin e një sistemi zgjedhor mazhoritar deri në miks me atë proporcional.

Në përcaktimin e sistemeve zgjedhore, nisur dhe nga praktika elektorale botërore, rol vendimtar luajnë kriteret të cilët ndihmojnë në ndërtimin e një modeli të caktuar përfaqësimi në parlament, gjë që do të ndikojë dhe në mbarëvajtjen e qeverisë. Ndër kriteret që mund të formulohen, duhet të ketë disa prioritete bazë. Pra sistemi kryesisht mazhoritar me një miksim të vogël proporcionali, erdhi si një domosdoshmëri historike që do të sillte në parlamentin shqiptar të pas '90, parti politike të gjithfarë ngjyrave dhe nuancave të tyre. Në fillimet e tij, parlamenti shqiptar do të kishte përfaqësime të aspekteve dhe interesave të ndryshme partiake,

të cilat më vonë nisën të grupohen në koalicione, ku interesat filluan të bëhen kolektive, ndërsa zëri parlamentar i deleguar. Koalicionet e brishta parlamentare kanë treguar në parlament shumë herë një vendimarrje jo të lehtë, një mungesë unisoni, për pasojë dhe bllokime të proceseve. Përfaqësuesit e partive politike në parlament, pjesë e koalicioneve të mazhorancës, shumë herë janë sjellë si individë të pavarur duke injoruar koalicionin madje dhe subjektin e tyre.

Pra historia parlamentare shqiptare, e ushqyer nga një sistem zgjedhor kryesisht mazhoritar, tregon se ky sistem e ka përmbushur tashmë misionin e tij, madje tejkaluar, duke nxjerrë dhe mangësi funksionimi. Vërshimi pluripartiak në politikën dhe parlamentin shqiptar, i cili numëron mbi 70 parti politike, nuk solli plotësisht atë ç'ka shqiptarët prisnin në të vërtetë nga kjo erë e re demokratike. Këto zhvillime tregojnë qartë domosdoshmërinë e kalimit nga një përfaqësim sasior në atë cilësor. Këtë do ta realizonte ndryshimi i sistemit zgjedhor, nga një sistem të ndërthurur mazhoritar me proporcional, në një sistem të pastër proporcional me një prag elektoral rreth 4 %.

## **Proporcional i pastër**

Jo pak herë është diskutuar një ndryshim i tillë, por ka ndeshur në filozofinë sasiore të përfaqësimit pluripartiak në parlament. Asnjë sistem demokratik nuk e frenon pluripartizmin parlamentar, madje një proporcional në të tilla nivele, do të shkundte partitë e vogla, por dhe të mëdha të rrisnin përkrahjen e tyre elektorale dhe të kalonin kufirin e nevojshëm. Nëse kjo nuk mund të arrihet nga partitë e vogla, ato do të detyrohen të krijojnë koalicione parazgjedhore të qëndrueshme dhe të garantuara për një vijim normal të parlamentit. Ndërsa elektorati, do të pozicionohej në ideologjitë e majta apo të djathta, dhe do të orientohej drejt programeve partiake të preferueshme për secilin.

Pra sistemi proporcional me një prag elektoral rreth 4 %, do të garantonte një funksionim normal të parlamentit, veçanërisht në vendimarrje, ku mazhoranca parlamentare do të garantonte një vijueshmëri të rregullt, larg rezistencave apo lëkundjeve personale të aleatëve parlamentarë.

Sistemi proporcional parlamentar është më i suksesshëm

përsa i përket jetëgjatësisë qeveritare, pjesëmarrjes së votuesve dhe aspektit ekonomik. Arsyeja pas gjithë këtij pretendimi, është se ndryshimet e vazhdueshme në qeveri, ndërmjet dy partive ideologjikisht të polarizuara, siç mund të ndodhë në sistemet mazhoritare, e bën planifikimin ekonomik afatgjatë me të vështirë, ndërsa koalicionet qeveritare më të gjera në proporcional ndihmojnë në krijimin e një stabiliteti dhe koherence në vendimmarrje, duke bërë të mundur zhvillimin kombëtar dhe avancimin e reformave ekonomike dhe institucionale.

Por sistemi proporcional do të shmangte individin si faktorin bazë në një proces zgjedhor dhe do të nxirrte më në pah subjektin politik. Ajo që dua të shtjelloj me këtë ide është se lista e kandidatëve të proporcionalit, e cila do të jetë shumë e filtruar nga forumet vendimmarrëse partiake, në zonën elektorale fillimisht do të çojë subjektin politik dhe më pas kandidatin. Kjo do të rrisë dhe aktivizimin e anëtarësisë duke i dhënë asaj pushtet, por dhe interesim më të madh ndaj subjektit të saj. Në këtë mënyrë do të minimizohet mjaft dhe fenomeni i personalizimit të kandidatit. Përvoja tregon se kur në një zonë elektorale ka ndryshime të dukshme pozitive, të gjitha atributet i merr deputeti i zonës, duke injoruar shumë herë subjektin që e ka kandiduar dhe që ai përfaqëson. Kjo është vënë re veçanërisht në rastet kur deputetët shkëputen nga subjekti i tyre politik duke dalë si forca më vete politike apo dhe të pavarur. Çdo investim i bërë nga buxheti i shtetit në zonën e tyre paraqitet si arritje dhe aftësi të individit, “harrohet” subjekti politik dhe qeveria nga ata vetë rridhnin duke mohuar kështu se ato janë kontribut i një politike rajonale apo dhe më gjërë brenda prioriteteve qeverisëse.

Sistemi proporcional do të kërkojë kritere të forta nga partitë politike për të formuluar listat e kandidatëve për deputetë. Sa më demokratike dhe e hapur drejt anëtarësisë të jetë një parti, aq më reale dhe objektive do të jetë lista e kandidatëve të saj për zgjedhjet parlamentare. Partitë politike duhet të ndërtojnë mekanizma të tillë që të shmangin subjektivizmin apo preferencat individuale në këtë përzgjedhje. Partitë të cilat kanë pranuar dhe aplikojnë parimin “Një Anëtar Një Votë”, për të patur një listë kandidaturash sa më përfaqësuese dhe dinjitoze, mund ta kalojnë atë nëpërmjet votës së anëtarësisë.

Një parti e demokratizuar brenda listës së saj do të mund

*Koha e një proporcionali të pastër dhe pragu më të lartë*

të kishte një përfaqësim më të mirë dhe më të gjërë të grave politikane, sesa një kandidim direk i tyre nëpërmjet mazhoritarit, përballë një shoqërie ende maskiliste.



### 3. Votimi elektronik, kaq larg dhe njëkohësisht kaq afër?

*Elton Beqiraj*

Zakonisht kur flitet për votimin elektronik, tendenca apo reagimi i parë janë: një buzëqeshje mirëdashëse ose një ngritje supesh dhe menjëherë të thuhet po, është një gjë e mirë, por akoma shumë moderne për kushtet tona.

Në të vërtetë termi modern në këtë rast mbulon një sërë argumentesh, që në fakt po të shihej më në thellësi, do të shfaqeshin me tërë thjeshtësinë e tyre. Për ta kuptuar më mirë konceptin le të bëjmë një hyrje të vogël.

Kohët e fundit me shumë ngulm po flitet dhe madje ka filluar edhe të praktikohet parimi “Një Anëtar Një Votë”. Nga të gjitha anët ky parim po shihet si një ide novatore që shërben për të modernizuar jetën politike, apo më saktë vendimmarrjen brenda partisë apo forcës politike.

Por në fakt ky sistem në vetvete nuk është as i ri dhe aq më pak modern (në kuptimin jo e modës, por si një zbulim i kohëve moderne). Ideja “Një Anëtar Një Votë”, në fakt është ideja më vjetër për sa i përket formës së votimit, e cila që në antikitetin e hershëm përbënte një nga bazat e demokracisë; por me kalimin e kohës, ndërlikimin e konceptit politik, rritjen e popullsisë (dhe si rrjedhojë edhe të votuesve), u zëvendësua me forma ose në disa raste sisteme të mirëfillta votimi shumë më të reja nga ana ideore dhe ana grafike, por jo detyrimisht më të mira.

Rikthimi në *modë* i këtij modeli kohët e fundit më të drejtë i është bashkangjitur votimit brenda përbrenda forcës politike, duke e afruar kështu me idenë origjinale të antikitetit ku votohej

brenda *polisit* për njerëz të cilët të përbashkët kishin qytetarinë dhe civilizimin; kurse në ditët e sotme idealin politik dhe afinitetin e ideve. Kështu duke pasur parasysh këto fakte mund të kuptojmë fare mirë se ideali politik i ditëve tona si dhe deklamimet mbi mbrojtjen dhe shenjtërinë e votës nuk ndryshojnë shumë nga idetë dhe problemet e antikitetit. Ashtu sikurse edhe modelet “e reja” politike ose manaxheriale me emra të kumbueshëm anglo-saksonë, p.sh. *multilevel system*, në vetvete s’janë veçse rimodelime apo përkthime të sistemeve të lashta ushtarako-civile të ROMËS antike.

Sigurisht të flasësh për antikitetin në një shkrim mbi votimin elektronik mund të lerë të çuditur shumë njerez (dhe madje të duket edhe si pa lidhje), por shpresoj se me këtë hyrje kam bërë të qartë që ndryshimi midis ideve të reja dhe atyre të vjetra qëndron sidomos në formën dhe teknikën e aplikimit, sesa tek vetë ato.

Dhe pikërisht për këtë arsye për ne të “të mbeturit kaq prapa”, votimi elektronik ndoshta nuk është edhe aq alien sa duket, por përkundrazi mund të jetë, në disa aspekte më i afërt dhe më realist, sesa imagjinohet. Për ta shqyrtuar më mirë problemin duhet të kemi parasysh pikat nga të cilat do të bazojmë këndvështrimin tonë; dhe këto janë: ana ideore, aspekti ligjor, nevojat praktike të aplikimit, si dhe kushtet teknike të çështjes (teknologjia).

## Ana Ideore

Nga ana ideore apo morale deri më sot, jo vetëm në Shqipëri, por në asnjë vend tjetër të botës nuk ka pasur asnjë kundërshtim mbi vlefshmërinë e votimit elektronik. Ky fakt tregon më së miri se këtu nuk kemi të bëjmë aspak me ndonjë problem social apo që mund të shndërrohet në një të tillë. Madje edhe përsa i përket sigurisë, janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren sisteme votimi që lejojnë një *hapësirë* manipulimi shumë më të madhe (zgjedhësit e dytë), apo një vonesë procedurale (votimi me postë), të cilat vazhdojnë të tolerohen për vetë specifikat e disa vendeve.

## Aspekti Ligjor

Për ne shqiptarët tashmë të brumosur me maksimumen autoktone se “ligjin e bën Maliqi”, ky aspekt mund të duket si i fundmi i

problemeve, por de facto është problemi kryesor në të gjitha vendet ku sundon (realisht) shteti i së drejtës. Pengesa më e madhe që has aplikimi i votimit elektronik në një pjesë të rëndësishme të vendeve të zhvilluara, është pikërisht barriera ligjore vendosur nga ligje që në vetvete janë konceptuar për të mbrojtur individin dhe privacinë e tij nga syri i kudondodhur i BIG BROTHER-it oruellian. Dhe ndryshimi apo abrogimi i këtyre normave ligjore nuk është aspak i lehtë, madje për disa rryma shumë të respektuara të mendimit juridik mund të jetë i dënueshëm. Për këtë arsye në këto vende ekziston sot për këtë pikë, një gjendje status quo-je e cila ndoshta do të vazhdojë e tillë deri në lindjen e një emergjence të diktuar nga nevojat praktike.

## Dobitë praktike

Në dallim nga pika e mëparshme dobitë praktike apo më saktë detyrimet për aplikimin e këtij sistemi për ne shqiptarët janë më të prekshme. Specifika jonë, si një vend me një emigracion të zhvilluar dhe të vazhdueshëm është decisive për gjykimin e problemit. Kësaj i shtohet edhe fakti që tek ne nuk ekziston asnjë barriera ligjore e modelit perëndimor, përkundrazi ata fatlumë që marrin viza mund të thonë shumë mirë se sa shkelje të *privacisë* janë të detyruar të pësojnë përfshirë këtu edhe skedimin e detyrueshëm (shenjat e gishtave). Nga ana tjetër vetë shteti shqiptar kohët e fundit ka publicizuar modelin e ri të patentës e cila do të përmbajë edhe shenjat e gishtërinjve si dhe elemente të tjerë identifikimi. Pra si përfundim justifikimi ligjor dhe moral përse i përket realitetit shqiptar nuk qëndron. Por në të kundërt qëndron sa një mal detyrimi moral i këtij vendi ndaj emigrantëve dhe diasporës. Dhe pikërisht këtu votimi elektronik merr një rol shumë të rëndësishëm.

Është fakt që gjithnjë e më shumë politika apo më saktë pjesa më e ndërgjegjshme e saj, po kupton rëndësinë e elementit votues që ndodhet jashtë vendit. Rëndësi kjo që shihet qartë po të marrim parasysh se numri i votuesve që ndodhen jashtë vendit sipas të dhënave zyrtare, është më shumë se gjysma e votuesve që morën pjesë në zgjedhjet e fundit (për pushtetin lokal). Dhe këtu bëhet fjalë për pjesën më me vizion (për arsye të kuptueshme) të elektoratit, dhe njëkohësisht për pjesën më pak

të manipulueshme, zgjedhjet e së cilës nuk mund të ndikohen nga interesat e momentit apo “çuditë” e fushatave elektorale shqiptare. Përsa i përket të drejtës së votës së këtyre njerëzve që me kursimet e tyre garantojnë një pjesë të mirë të të ardhurave të këtij vendi, askush nuk ka kundërshtuar të drejtën ose më saktë shenjtërinë e saj, por gjithmonë kundërshtitë janë ndeshur për të përcaktuar mënyrën sesi kjo mund të realizohet. Dhe këtu paradokset s’kanë të sosur. Janë shpikur receta nga më të pamundurat: që nga transportimi i detyrueshëm prej shtetit i emigrantëve nëpër qendrat e votimit (gjë që për të qenë të qartë është qesharake edhe për sa i përket votuesve brenda vendit), gjer tek votimi me postë; kur tek ne është e pamundur të sigurosh transportin me skortë të një kutie votimi, mendo sigurinë që i duhet fluksit prej qindra mijë letrash-vote?

Pra siç duket ajo formë votimi që dukej e largët, moderne dhe për këtë e papranueshme në fund mbetet si shpresa e fundit, për të mbrojtur një të drejtë themelore si ajo e votës.

Siç e shpjeguam më lart midis votimit elektronik dhe atij të çfarëdoshëm (si koncept) i vetmi ndryshim është termi elektronik, i cili na bën t’i imagjinojmë saktë mundësitë që ofron. Në fakt opsioni më i rëndësishëm që teknologjia ofron në këtë rast (njëkohësisht edhe ai që ne na intereson më tepër), është shpejtësia e identifikimit dhe monitorimit të listave të zgjedhësve.

Kushdo që është përballur me rinovimin e lejeve të qëndrimit në Europë kohët e fundit mund të thotë se përveç dokumentacionit normal tashmë kërkohen edhe shenjat e gishtërinjve, gjë që bën të mundur identifikimin e sigurt të personave të cilët për arsytet dhe hallet e emigracionit që aq mirë i njohim ne shqiptarët, kanë qenë të detyruar edhe të ndryshojnë identitetet. Këto elemente, identifikimit të të cilave u shtohen edhe të dhëna të tjera të vjelura nga dokumentacioni që zakonisht kërkohet, formojnë një *bazë të dhënash*, e cila në çdo moment është në dispozicion të organeve kompetente dhe që në teori shërben për kontrollimin e krimit dhe të emigracionit ilegal në BE. Ideja është që i gjithë ky sistem i menduar për arsytet e mësipërme, të përdoret për një qëllim shumë më human dhe shumë më të nevojshëm për vendin tonë: **krijimin e një liste të përpiktë votuesish në secilin nga vendet e emigrimit**. Në këtë mënyrë në bazë të një kërkese preçize nga ana e shtetit shqiptar këto lista mund të vihen shumë lehtë në

dispozicionin tonë, aq më tepër që nuk ekziston asnjë bazë ligjore që të përbënte pengesë. Problemi i vetëm në këtë pikë është përdorimi praktik i këtyre listave.

Ideja më e parë do të ishte përdorimi i kësaj vote në listen proporcionale (duke parë problemet e ndarjeve gjeografike të zonave zgjedhore), por me një reflektim më të kujdesshëm mund të mendohet edhe një aplikim më i gjerë.

Prej kohësh qeveria shqiptare deklaroi se ka nëpër gjendjet civile lista të sakta të popullsisë, përfshi këtu edhe të emigruarit, të cilët në bazë të ligjit thirren rregullisht për të votuar edhe për kandidatët e listës mazhoritare. Do të mjaftonte një verifikim i këtyre listave në bashkëpunim me organizmat europianë për t'i dhënë të drejtën e njohjes, votës së një emigranti në kolegjin elektoral përkatës. Jemi të sigurt se edhe për vetë organizmat europianë një projekt i tillë do të rezultonte më interesant sesa pjesa më e madhe e projekteve (shpesh të pakuptimta), që aktualisht zbatohen.

## **Kushtet teknike**

Pa diskutim ekziston teknologjia e nevojshme për të realizuar një projekt të tillë! Madje kostoja e kësaj teknologjie mund të rezultojë më e vogël sesa ajo trainimeve të shumta që u bëhen komisionerëve nëpër qendra votimi, dhe do të prodhonte një rezultat shumë më domethënës, përse i përket sigurisë së votës si dhe vetë rezultatit të votimit. Pika më e rëndësishme këtu mund të bëhej garantimi i qendrave të votimit në një vend të huaj, si dhe komisioni i votimit.

Në këtë rast ambasadat dhe konsullatat (atje ku ekzistojnë) e shtetit tonë do të përbënin terrenin ideal për zhvillimin e votimeve, duke u dhënë kështu edhe atë plusin e krenarisë kombëtare aq të nevojshme në vend të huaj. Përse i përket komisionit të votimit ky fare mirë mund të përbëhet nga vetë ekspertët elektronikë (sigurisht të huaj), që do të monitorojnë edhe anën teknike, ashtu sikurse edhe nga ndonjë komision dy-palësh i krijuar *ad hoc*. Por garancinë e vërtetë e përbën vetë sistemi i votimit ku votuesi do të identifikohet automatikisht thjesht nga vendosja e gishtit mbi aparaturë (siç ndodh tashmë pothuajse në të gjitha pikat e kontrollit të aeroporteve perëndimore, për ne shqiptaret), dhe njëkohësisht

duke qenë se fleta e votimit në këtë rast, do të ishte në formën e një ikone kompjuteri edhe përpunimi i të dhënave do të bëhej në kohë reale. Rezultati i votimit në këtë mënyrë s'do të linte vend për kontestime pasi prej kohësh jemi mësuar të mendojmë se për ne shqiptarët, të vetmit “gjykatës” në rast zgjedhjesh janë faktorët ndërkombëtarë.

Në këtë shkrim u mundova të shpjegoj paradoksin e realitetit tonë ku ajo që mungon me të vërtetë s'është modernia, apo ultra teknologjia; përkundrazi është ajo më antikja dhe më primitivia: **IDETË dhe VULLNETI I MIRË!**

## 4. Zgjedhjet si një nga mekanizmat kryesorë që prodhojnë demokraci

*Armand Bora*

Zgjedhja, në kuptimin e saj të përgjithshëm, është një nga të drejtat themelore të qënies njerëzore. Çdo individ ka të drejtë dhe i duhet krijuar gjithnjë mundësia që të zgjedhë midis dy a më shumë shërbimeve për të cilat ai ka nevojë, argëtimeve, partneriteteve në punë a në shoqëri. Në fund të fundit, i gjithë veprimi njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një zinxhir i pandarë zgjedhjesh dhe përzgjedhjesh, rrjedhojat a pasojat e të cilave konsiderohen si përgjegjësi të vetë përzgjedhësit. Pikërisht, mbi këtë argument e zhvillon idenë e tij Zh.P.Sartër në librin “Ekzistencializmi është humanizëm” duke e konsideruar ekzistencializmin si një filozofi jo vetëm humane por edhe optimiste në kundërshtim me fatalizmin apo determinizmin.

Edhe zgjedhja si një akt politik, nuk ndryshon në thelbin e saj nga zgjedhjet e tjera që bën njeriu në jetën e përditëshme. E rëndësishme është që të theksohet se edhe kur bëhet fjalë për këtë lloj zgjedhje, përgjegjësia nëse ajo është e drejtë apo e gabuar bie mbi zgjedhësin. Ajo që e bën më të veçantë dhe më të rëndësishëm këtë akt, në krahasim me zgjedhjet e tjera të përditshmërisë njerëzore, është institucionalizimi dhe roli i saj si një nga mekanizmat kryesorë që ndikon në cilësinë e demokracisë. Është kaq i rëndësishëm ky mekanizëm sa shpesh herë për të matur shkallën e demokracisë që ekziston në një vend të caktuar, midis shumë treguesve të tjerë, merret në konsideratë mënyra se si relizohet procesi zgjedhor. Treguesi që zbulon dallimin midis një sistemi liberal demokrat dhe një sistemi diktatorial, monist, absolut

dhe autoritarist është, pikërisht, hapësira e lirisë dhe mundësisë për të zgjedhur. Vetë eksperiencia e shoqërisë shqiptare, në vitet e sistemit monist, është shembulli më i mirë i mungesës së demokracisë duke e sanksionuar me ligj mungesën e alternativës si një mundësi tjetër përzgjedhje jo vetëm në politikë, por edhe në shërbime, shëndetësi, arsim, punësim etj.

Vetëm sistemi politik në të cilin opozita lejohet të luajë rolin e saj si forcë rivalizuese, konkurrese si shprehje e ekzistencës së një alternative tjetër, mund të konsiderohet si një sistem demokratik. Në këtë sistem politik garantohet vëmendja ndaj parapëlqimeve të qytetarëve duke i konsideruar ata si qenie të barabarta dhe duke ju siguruar qytetarëve tre mundësitë e mëposhtme të përcaktuara nga R. Dahli:

1. Që qytetarët të mundin të formulojnë parapëlqimet e tyre.
2. Që t'i bëjnë ato të njohura për njëri-tjetrin dhe për qeverinë përmes aksionit individual ose kolektiv.
3. Që ato të vlerësohen jashtë çdo diskriminimi për shkak të përmbajtjes ose burimit të tyre.

Natyrisht që pika e tretë përmban në vetvete në një kuptim të saj më të gjerë, idenë e domosdoshmërisë së respektimit në zgjedhje të pakicave (politike, etnike apo të përkatësive të tjera) si një nga kushtet e funksionimit të demokracisë. Duke ju referuar përsëri Dahlit, në librin e tij "Poliarkia pjesëmarrja dhe opozita", ai saktëson tetë garanci institucionale që duhet të krijohen për të siguruar tre mundësitë e mësipërme. Nuk është e rastësishme që midis këtyre tetë kushteve institucionale:

- a) e drejta e votës dhe;
- b) zgjedhje të lira e të ndershme, janë dy nga më kryesorët.

Nga ç'ka thamë më lartë e për shumë arsye të tjera besoj se është qartësisht e kuptueshme domosdoshmëria e mundësisë së zgjedhjes për të siguruar një normalitet jetësor. Pyetja që do të shtroj është se përse bëhet e rëndësishme dhe e domosdoshme zgjedhja si një akt politik? Edhe pse në pamje të parë dukjet sikur kemi shtruar një pyetje naive dhe shumë të lehtë për t'i dhënë një përgjigje, kjo pyetje mbart në vetvete shpjegimin e pyetjes se: çfarë e bën një sistem demokratik të mos mundet të funksionojë pa procesin zgjedhor? Nëse do të niseshim nga shpjegimi etimiologjik i demokracisë atëherë do të kishim kuptimin e një pushteti të të gjithë popullit i cili nuk krijonte hapësirë as për të



papushtetshëm dhe as për mbi të pushtetshëm. Një demokraci e tillë e shtrirë në planin horizontal ka funksionuar në Greqinë e lashtë dhe për shumë arsye nuk mundi të vepronte më gjatë. Si nevojë e funksionimit të demokracisë edhe në planin vertikal dmth hierarkik u përforcua, sofistikuua dhe institucionalizua procesi i zgjedhjes. Nëse do të pyesnim se përse është e domosdoshme të organizojmë zgjedhje apo se çfarë është ajo që presim të dimë pas mbajtjes së zgjedhjeve, për pjesën dërrmuese të të pyeturve përgjigjia do të ishte: “zgjedhim shumicën drejtuese”. Këtë koncept mbi qëllimin e zgjedhjeve e ndeshim edhe në ligjëratat e politikanëve tanë të cilët shpesh herë i referohen shumicës, të drejtës dhe legjitimitetit që ajo u jep në marrjen e vendimeve të tyre.

Për ironi të kësaj situatë duhet pranuar se koncepti i shumicës, që përfiton attribute, nuk nis me demokracinë greke, bile as me romakët. Që nga ajo kohë e deri në shekullin e 17-të funksionoi parimi i unanimitetit dhe jo e drejta e shumicës për të sunduar pakicën, dmth funksionimi mazhoritar por pa të drejta të shumicës. Ishte Loku (filozof anglez) ai që, për herë të parë, përfshiu të drejtën e shumicës në një sistem kushtetues i cili e kontrollonte dhe e disiplinonte atë. Pyetja që ngrihet me të drejtë është kjo: përse një numër më i madh fiton, automatikisht, më shumë të drejta ndaj një numri më të vogël? Dhe akoma më tej, përse te një sasi numerike duhet domosdoshmërisht që të jetë edhe cilësia? Argumentat që të bindin për të kundërtën e këtyre gjasave janë të shumta.

Gjithsesi, nuk do rri pa përmendur presidentin Xheferson, ku në vitin 1801 ai deklaronte se “edhe pse vullneti i shumicës duhet të mbizotërojë kurdoherë, ky vullnet, që të jetë i drejtë duhet të jetë i arsyeshëm”. Nëse do ta varionim deklaratën e presidentit Xheferson në realitetin shqiptar, do të thoshim se e arsyeshme është vetëm ajo pjesë e së tërës që përmban urtësinë, përgjegjshmërinë, aftësinë, vendosmërinë dhe shumë përbërës të tjerë të cilësisë. Më i thjeshtëzuar, problemi përmblihet në domosdoshmërinë që, duke filluar nga zgjedhjet e afërta parlamentare nevoja, për të përzgjedhur cilësinë duhet të dalë mbi nevojën e të siguruarit të shumicës. Natyrisht që një qëndrim i tillë idealist, i qytetarit përpara kutisë së votimit, nuk përputhet me qëndrimin pragmatist të partisë. Në kahun e lëvizjes së njerës ndaj

tjetrës do të duhej që oferta, të cilën servir partia, duhet të tentojë t'i afrohet kërkesës së qytetarit për më tepër cilësi. Kërkesa për përzgjedhje cilësore apo teori të ndryshme elitariete nuk i kanë munguar historisë së zgjedhjeve. Në Shqipëri, edhe pse me një histori jo shumë të gjatë të zgjedhjeve demokratike paraqitet si i nevojshëm theksimi i tezës së seleksionimit të vlerave.

Për vetë kjartësinë e shprehjes së kësaj ideje në librin “Ç’është demokracia” të G. Sartori do të doja që ta mbyllja këtë argument me një pasazh të shkëputur nga ky libër. “Nëse zgjedhjet duhej të ishin një instrument cilësor i përshtatur për të arritur një përzgjedhje cilësore, kërkesa për të siguruar numra ka nënshtruar kërkesën e vlerësimit.

Mekanizmi e ka kapur për dore makinistin dhe, nëse qëllimi ishte numërim për të zgjedhur, demokracitë e sotme funksionojnë duke numëruar shumë e duke zgjedhur pak. Tirania e numrave “rivlerëson sasinë” dhe, kështu zhvlerëson cilësinë. Ligji i Greshemit: paraja kallpe dëbon të mirën, zbatohet edhe për zgjedhjet edhe për të zgjedhurit e kohës sonë”.

## 5. Meritokracia... të jesh a të mos jesh!

*Rezear Kolaj*

“...nëse sheh 10 vjet para të tjerëve puno tokën...  
...nëse sheh 100 vjet... mbill pemë...  
...nëse sheh 1000 vjet përpara... arsimo njerëzit...”

Çdo **punë** njerëzore karakterizohet nga parametra **cilësorë** dhe **sasiorë**. Shpesh herë ne shohim se një investim publik është i arrirë por ne nuk dimë se sa është shpenzuar për këtë gjë. Në mungesë të informacionit, ne e kemi të vështirë të kuptojmë se me çfarë buxheti realizohet ky investim dhe sa kushton një **punë** e tillë. Pra nuk dimë sa **efektivë** jemi.

E nisa kështu shkrimin tim sepse rëndom në kiakëritjtet e përditshme, ne dëgjojmë të thuhet se iks administrator publik ka bërë këtë, apo atë vepër publike “bukur”, ai është “punëtor”, “e meriton” votën tonë. Kjo sigurisht është vetëm njëra anë e medaljes.

Ndoshta prej këtu e kanë zanafillën e tyre disa nga njerëzit aktualë të politikës, të cilët padyshim janë administratorë në fushat e shërbimeve, e që vijnë dhe definoohen si kandidatët tanë vendorë apo qendrorë.

Duket se parlamenti ynë jetë e mot do të ketë të njëjtën strukturë, në shumicë: mësuesit e gjuhëve të huaja, mjekët, gazetarët, piktorët, muzikantët etj., etj., etj.

Aktorët realë nga biznesi apo të kualifikuarit jashtë shtetit janë në minorancë.

Ndoshta kjo edhe nën presionin “ludist” të asaj pjese të politikës e cila ende nuk ka kuptuar se **shteti drejtohet nga klasat ekonomike në bashkëpunim me vlerat e shoqërisë**.

Duke qënë se Shqipëria nuk ka institucione të mirëfillta që merren me burimet njerëzore, brenda apo jashtë partive, që të

studiojnë dhe më pas të përzgjedhin individët, ne thjesht vonojmë shfaqjen e **vlerave**.

Të gjithë ne e dimë se sot kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar është z. Tony Bler, por shumë pak e dinë se për të fituar zgjedhjet pas mandateve radhazi të Konservatorëve, Laburistëve iu është dashur që të punojnë plot 15 vjet me djaloshin e ri Bler, për të patur një kryeministër – burrë shteti si ky i sotmi.

Organizatata tona rinore apo grupet qytetare nuk po arrijnë ende të “nxjerrin në treg” njerëzit e mendjes, të përpunuar e parafabrikuar siç duhet. Ne jemi një vend ku njerëzit nuk promovohen nga partitë apo organizatat qytetare por thjesht vetëpropozohen. Madje këtë gjë po e shohim aq shpesh kohët e fundit, sa që kam filluar të dyshoj nëse kanë mbetur më parime dhe norma të etikës në këtë vend.

Është vërtet një “mision i pamundur” për kohën në të cilën jetojmë por edhe për prioritetet që ka ky vend, është fare e panevojshme.

Unë mendoj se bazuar në statistikat ekonomike Shqipëria, nuk ka nevojë për shumë politikë dhe shërbime të tjera, sesa për **cilësinë** e tyre. Partitë politike duket se janë ende të papregatitura në strukturë për të diskutuar alternativat në nivel intelektual mirëfilli dhe për të bërë përzgjedhjen e nevojshme për të zgjedhurit-kandidatë.

Të gjithë e dimë se cilado mazhorancë që do të qeverisë Shqipërinë e pas 2005-ës padyshim do të përballet me sfidën tonë tanimë të shkruar në mendjen e gjithkujt, rritjen ekonomike, korrupsionin, integrimin e vendit. Në fakt pikërisht se si do të realizohen këto sfida dëgjojmë pak. Nëse do ti hedhësh një sy listës së kandidatëve të të gjithë spektrit politik shihet se mungojnë njerëz pikërisht nga fushat prodhuese apo ato ekonomike.

Postulati amerikan “**...bota qeveriset nga dy kategori shoqërore... juristët dhe ekonomistët...**” që këtu, duket i pavërtetë. Tek ne dihet se importet kanë një avantazh përballë eksporteve, megjithëse vitet e fundit ky raport ka filluar të lëvizë, shumë rrallë ne diskutojmë se si të “dalim nga ky mort”.

Duhet medoemos që politikat tona të prodhojnë mirëqënie, në mënyrë që rritja ekonomike të mos jetë e rastësishme por **veti** pikërisht e qeverisjes sonë.

Ka ardhur koha që problemeve të caktuara t’iu vëmë emrin

që kanë. Ne duhet të bëjmë studime parashikuese dhe planifikim të detajuar se çfarë do të bëjmë me perspektivën e këtij vendi. Duhet të vëmë nën kontroll të gjitha burimet potenciale prodhuese në funksion të misionit tonë.

Ne të gjithë e dimë se **toka** në ndryshim me çdo **mall** tjetër është një **pasuri e patjetërsueshme**.

Në proçesin e tanishëm të ndarjes së tokës ne duhet të fillojmë të mendojmë për hapat që do të hedhim, në mënyrë që shoqëria të ketë dobi dhe reforma të mos degradojë në një tjetër kioskizim i cili do të na frenonte shumë në krijimin e ekonomive moderne bujqësore. E përdor këtë term pasi ne nuk mund të lejojmë që kushdo të mbjellë çfarëdo, në cilëndo sipërfaqe toke.

Paralel me ndarjen ne duhet të kemi shumë të qartë se çfarë do të prodhojmë dhe të provojmë se jemi të aftë në kultura të tilla që prodhojnë “high quantity of money” në sipërfaqet tona të kufizuara bujqësore.

Njerëzit që jetojnë në fshat për të qënë vërtet fermerë duhet të kenë fermë, pra të bëjmë që toka e tyre të jetë një mall me **vlerë**, ajo duhet të prodhojë **vlera**, ndryshe në fshatrat tona do të ketë vetëm njerëz që emigrojnë, apo shkëmbejnë prodhimet e tyre në natyrë, të cilët nuk blejnë as buzëkuq për gratë e as libra për fëmijët e tyre, me dy fjalë nuk janë **konsumatorë**.

Nëse në Shqipëri jetojnë afërsisht 46% e popullsisë në fshat ne nuk duhet të shqetësohemi pikërisht për këtë gjë, por duhet të përpiqemi të bëhemi sa më efektiv në politikat tona rurale. (Gjermania me 1% të njerëzve që merren me bujqësi siguron 4% të GDP-së, Shqipëria me 46% siguron rreth 27% të GDP-së).

Të gjithë e dimë se një vend i cili nuk prodhon produktet bazë për të jetuar nuk prosperon dot. Me gjithë progresin konstant në bujqësi gjatë 8 viteve të fundit dhe veçanërisht indeksin e investimeve gjithnjë në rritje në mandatin e fundit, ne nuk mund të jemi të kënaqur. Ne duhet të punojmë më shumë që të kreditohet bujqësia, dhe të sigurohet ajo. Kapitalizëm do të thotë efektivitet, pra duhet të inkurajojmë pikërisht ato degë të ekonomisë bujqësore të cilat prodhojnë mirqënie.

Ne duhet të dimë me saktësi numrin e saktë të kafshëve në ekonomitë blegtorale, në mënyrë që të planifikohemi, të dimë se përse do të investohet, ku do të shkoj ky investim dhe çfarë të mira sjell.

E gjitha kjo krahasuar me përvojën botërore do të sjellë një mendësi globale në ekspansion dhe do të na ndihmojë të integrohemi më lehtë. Në këtë vend duhet të strukturohet një herë e përgjithmonë tregu, e të ndahet përfundimisht **prodhuesi**, nga **shitësi** grosist dhe ai me pakicë.

Përveç të tjerave, kjo me siguri do të sjellë atë që në ekonomi quhet **reaksion zinxhir**, pra **zhvillim**. Ka ardhur koha që ne shqiptarët të dimë dhe të njohim mundësitë që kemi.

Në librat japonezë të klasës së parë, fëmijve u thuhet pak a shumë “... **atdheu ynë është një vend në shkëmb ... që ka pak mundësi ... prandaj ne na duhet shumë punë ... për ti bërë ballë jetës...**”.

Shqipëria është një vend me pak resurse në dispozicion. Kjo nuk është e re, është koha të lexojmë faktet. Ne pikërisht, duhet të fillojmë të **administrojmë** mirë mundësitë që kemi. Në këtë ndërmarje patjetër duhet pjesëmarrja e rinisë, për të harmonizuar interesat dhe për të siguruar vazhdimësinë.

Shqipëria ka nevojë për të rinjtë e këtij vendi të cilët do të punojnë tokën e do ta mbjellin atë, që do të martojnë e trashëgohen me vajzat e bukura shqiptare.

## 6. Sistemet zgjedhore

*Ndriçim Hasanaj*

Mungesa e përvojës dhe trazicioni që po kalon vëndi ynë si në shumë fusha të zhvillimit të demokracisë ka problemet e veta dhe me hartimin e një sistemi zgjedhor të mirë dhe të qëndrueshëm. Gjithmonë që afrojnë zgjedhjet parlamentare në Shqipëri zhvillohen debate rreth sistemit zgjedhor dhe jo për përmirësime të tij. Kjo ndodh jo se sistemet që aplikohen janë të keq por se vullnetet politike për zbatim me përpikmëri të tij kanë munguar. Përvoja e këtyre viteve ka qënë, që është përdorur një kombinim i sistemit zgjedhor midis sistemit mazhoritar dhe atij proporcional pavarësisht numrave që janë përdorur për secilin sistem.

Por gjithmonë diskutohet se cili sistem është më i miri në kushtet në të cilat ndodhemi. Momentalisht kemi kombinim në pamje të parë, të sistemit mazhoritar e proporcional por shpërndarja e vendeve sipas sistemit proporcional në kodin zgjedhor ka sjellë dhe do të pasqyrojë edhe për këto zgjedhje difekte dhe deformim të vullnetit të zgjedhësve krahasuar me rezultatin që përftohet për numrin e vendeve në Parlament.

Gjatë zgjedhjeve të 2001 patëm faktin që nga 1 zonë e vetme elektorale të prodhoheshin 13 deputetë me të ashtuquajturin “Fenomeni Dushku” por me ligjin e ri do të prodhohet një “dushk i ri”, por me metoda të tjera që nuk shpreh realisht vullnetin e zgjedhësve. Zgjedhjet e 2001 lejuan fenomenin e kandidatëve të pavarur vetëm për të përfituar në mënyrë abuzive nga shpërndarja e vendeve të proporcionalit. Në këtë prag zgjedhje qarkullojnë zëra për rrëshqitje të votave në aleancat e majta për të deformuar

rezultatit zgjedhor. Kjo mendoj se do të ketë pasojat e veta të dëmshme në parlamentin e ri.

Praktikisht mendoj se kombinimi i sistemeve zgjedhore në Shqipëri është i drejtë për momentet që po kalojmë por Shqipëria duhet të kalojë në sistemin proporcional për disa arsye. Në zbatimin e sistemit zgjedhor mazhoritar ka disa të mira si: siguron një alternim të pushtetit më të sigurt, nuk flitet shumë për pazare me parti të vogla, përfshin shumë elemente të shoqërisë përjashtohen ekstremizmat e partive në parlament. Ruhet lidhja ndërmjet zgjedhësve dhe deputetëve pra rritet llogari - dhënia dhe kjo i bën ata të zgjedhin midis njerëzve se sa midis partive por ky sistem në kushtet që po kalojmë ka dhe shumë disavantazhe si: fillon konflikti që në ndarjen zonale ashtu sikurse e pamë në kohët e fundit, zgjedhjet i fiton "i forti" që ka pushtet, ka para, manipulon zgjedhësit dhe përdor të gjitha mjetet e ligjshme dhe jo të ligjshme për ti fituar ato, bënë që disa rajone apo qarqe dhe pse një Parti merr 30 – 40 % zgjedhësve të mos përfaqsohen në Parlament me asnjë deputet.

Gjithashtu ndikon në aftësinë e grave për të zgjedhur në parlament pasi ato kanë më pak shanse për tu zgjedhur si kandidatë në shtresat e partisë, por dhe të pjesëve të tjera të shoqërisë si romët, minoritetet duke i bërë këta të fundit që nëse nuk përfaqësohen, ekstremistët e tyre mund të mobilizojnë lëvizjen kundër sistemit. Si përfundim nga ky sistem kur mungon vullneti politik dhe ka prezenca të theksuar të korrupsionit do të fitoj jo domosdoshmërisht më i miri, por "më i forti" gjë që sjell pasoja në zhvillimin e vendit.

Sistemi proporcional sipas mendimit tim redukton pabarazinë mes pjesës së votës kombëtare por një parti dhe përfaqësimit të saj në Parlament.

Sistemi proporcional përdoret kryesisht në Europën Përfundimore me demokraci të konsoliduara, atëherë si vend që aspirojmë demokracinë dhe vendet Euro-Atlantike duhet të aplikojmë këto sisteme pasi ka këto avantazhe.

Shmang të gjitha të metat e sistemit mazhoritar, si rezultatet e pandershme, të kandidatëve apo dhe në shpërndarjen e vendeve shtesë.

Për konsolidimin e demokracisë duhet të kemi përfshirjen e të gjitha grupeve. Partitë e vogla përfaqësohen në parlament dhe



nuk urdhërohet vota nga partia që dëshiron në një parti aleate. Çdo votë ka vlerë pasi një zonë me më pak elektorat kompozon një zonë tjetër duke fituar një vend më shumë. Nxiti partitë të sigurojnë e të hartojnë lista të balancuara kandidatësh që i përgjigjen dhe interesave të të gjitha shtresave. Me këtë sistem rritet numri i grave në politikë pra nuk e kufizon aftësinë e tyre duke bërë që shumë parti kanë në startet e tyre përfaqsimin me mbi 25% të tyre. Meqenëse vendi ynë ka një sasi të vogël minoriteti të lokalizuar i bënë ato të përfaqësuar por jo si të ndarë nga pjesa tjetër. Qeveria e krijuar nga ky sistem mendoj se është më afatgjatë dhe ka një sistem ekonomik më të qëndrueshëm duke krijuar një stabilitet dhe konferencë në vendim-marrjen duke bërë të mundur zhvillimin e vendit.

Votuesit shqiptarë do të votojnë alternativat që i shohin më të mira dhe të pa ndikuar. Por si çdo gjë dhe ky sistem ka disa të meta si: nuk arrin një lidhje mes deputetit e zonës. Në kushtet tona të tranzicionit çon në koalicion që mund të çoj në krizë parlamentare duke mbajtur peng Partinë e madhe nga të voglat si pasojë e pazareve duke bërë që disa parti parti inekzistente por dhe ekstremiste të jenë prezente gjithonë në qeveri. Por një e metë kryesore është dhe çimentimi i listave nga Partia i të njejtave figura politike mjafton ta kesh mirë me kryetarin apo kryesinë. Megjithë këto difekte mendoj se ky sistem është më i favorizuar në kushtet tona pasi themi që po konsolidojmë edhe partitë tona pasi duke patur demokraci të mbrendshme në parti themi që edhe listat do të jenë shumë koherente me votuesit sidomos tani që pothuajse të gjitha partitë politike kryesore parlamentare kanë pranuar të fillojnë arimin “Një Anëtar Një Votë” ku me të mirat dhe të këqijat e fillimit themi se do konsolidojmë demokracinë dhe pse jam për një ligj të pastër proporcional.

Ky tranzicion i tejzgjatur dhe mungesa e plotë e vullnetit politik për të bërë zgjedhje të lira dhe për të patur demokraci të brendëshme në parti më bënë të besoj se dhe për disa vite duhet të ketë sistem të kombinuar zgjedhor midis mazhoritarit dhe proporcionalit kështu siç është tani përgjithmonë i qëndroj idesë se kjo shpërndarje e votave në sistemin proporcional që kërkohet të aplikohet në këto zgjedhje jam kundër. Megjithëse Shqipëria i ka shanset e fundit për të bërë zgjedhje të lira e të ndershme mendoj se duhet të ndryshojmë, të kenë këtë vullnet politik, të

mos kihet frikë nga alternimi i pushtetit si një nga parimet kryesore të demokracisë. T'i tregojmë vetes dhe të tjereve se e meritojmë integrimin Euro - Atlantik e duam demokracinë dhe do t'i bindemi asaj.

## 7. Çfarë nënkuptojnë zgjedhjet

*Fatmir Roshi*

Zgjedhje, nuk është thjesht një fjalë e artikuluar bukur, ose me delikatesë, në gojën e një gazetari apo politikani. Në brendësi të kësaj fjale shtrihen lirshëm arteriet kryesore, që ushqejnë të gjitha proceset, dhe reformat demokratike të një vendi apo të një populli, që aspiron vërtet demokraci. Procesi zgjedhor është një proces, që sjell natyrshëm rotacionin, ose rikonfirmimin e një pushteti, të një partie apo grupimi partish në koalicion. Në vendin tonë ky proces ka qenë gjithmonë, i njollosur dhe i përfolur, ka qenë një proces i asfiksuar, dhe i kontestuar. Të gjithë organizmat ndërkombëtarë kanë shprehur nota negative, për të gjitha stadet e procesit zgjedhor në tërësi. Gjëja më e keqe që mund t'i bëhet njeriut është ajo, që t'i mohohet e drejta e zgjedhjes.

Është e njëjta gjë sikur jeta e tij të varej nga të tjeret dhe jo nga ai vetë. Këto janë simptoma të një regjimi të lënë pas, të cilat duhet të zbuten deri në zhdukje për një sistem që ndërton demokraci reale. Rëndësi madhore në procesin e zgjedhjeve luan media, e cila është pasqyrimi apo trasparenca e zgjedhjeve të lira. Mediat janë ato, që përçojnë mesazhet e partive dhe të kandidatëve, të programeve të zhvillimit apo të regresit, sipas konceptit të çdo partie, që merr pjesë në fushatë. Pasqyrimi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme i aktivitetit në fushatë të këtyre partive, apo kandidatëve të tyre në hapësirat mediatike, në atë të shkruar dhe atë elektronike, është një faktor jo i rastësishëm, por fati demokratik i një vendi.

Duke vërejtur hapësirat jo transparente, dhe goxha të

njëanshme të mediave shqiptare, nuk ka sesi të të shkojë mendja, që këto zgjedhje mund të jenë të lira dhe të ndershme. Media nuk janë thjesht gazetarët, të cilët gjenden në to për të pasqyruar realitetin, por është vullneti i një qeverie, që përdor mekanizma jo demokratike, por detyruet për një media të shkruar apo elektronike të pasqyrojë interesat e saj, duke lënë jashtë atë të publikut. Një qeveri, që nuk çliron transparence publike, çdo ditë dhe çdo orë përdor të gjitha mekanizmat ekonomik, politik dhe gjyqësor për të mbajtur nën presion të vazhdueshëm mediat. Nëpërmjet kësaj, arrin të drejtojë opinione të pambështetura në një realitet të plotë.

Qeveritë duhet të lenë mediat, të pasqyrojnë realitetin dhe kjo e gjitha, është në interes të fushatës, të zgjedhjeve në tërësi dhe të publikut, që dëshiron demokraci në metodë. Zgjedhje nuk është thjesht hedhja e një letre në kuti votimi, ku është shkruar, emri i partisë apo i kandidatit, në një datë të caktuar të dekretuar nga presidenti, por hapësira demokratike informative mediatike, e cila mund të çojë në zgjedhjen e partisë dhe të kandidatit të duhur, për të çuar vendin dhe reformat jetësore përpara.

Një rëndësi tjetër në zgjedhje ka përfshirja e të gjitha shtresave të popullsisë, në të drejtën e tyre të zgjidhen dhe të zgjedhin. Hartimi i listave të sakta në gjithëpërfshirjen e çdo shqiptari në votime, sipas komuniteteve ku ata jetojnë, është një normalitet demokratik i detyrues, që tregon për respiracion normal, të jetës komunitare të një populli. Mënyrat dhe vendet e votimit, në lehtësi të zgjedhësve të të gjitha shtresave, të mundura ose jo fizikisht është detyrë organizative shumë e rëndësishme, dhe pjesë e realitetit zgjedhor. Duhet hequr dorë nga politikat ishemike, të përdorura në zgjedhjet e kaluara, në mosregjistrimin dhe mohimin e të drejtës së votës së qytetarëve. Duhet të zgjidhet mënyra e votimit të njerëzve me paaftësi fizike, si dhe votimi elektronik për emigrantët, të cilët janë nënshkretas shqiptare dhe duhet të marrin pjesë aktive, në zgjedhjet e vendit të tyre.

## 8. Zgjedhjet dhe Shqipëria

### *Sokol Terihati*

Të mësuar për 50 vjet me zgjedhje qesharake, në fillim të viteve 90 shqiptarët u ndodhën përpara ndryshimit dramatik të sistemit, nëpërmjet lëvizjeve masive, por edhe një sistemi zgjedhor të cilin s'e kishin provuar ndonjëherë. Sot në vitin 2005 situata është krejt tjetër.

Për shumë arsye, të mungesës së eksperiencës apo edhe të dëshirës së klasës politike, pas vitit 92, asnjëherë Shqipëria nuk arriti të bëjë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kjo ka sjellë një shqetësim serioz në Komunitetin Ndërkombëtar si edhe ftohje të elektoratit ndaj politikës.

Nëse vota e hedhur nuk numërohet por tjetërsohet, kjo është goditja më e rëndë që mund t'i bëhet sistemit. Është kjo arsyeja themelore e destabilitetit politik dhe e krizës së thellë sociale dhe ekonomike që përjeton sot vendi.

Të ndodhur përballë një tranzicioni të tejzgjatur vendit po i kanoset një rrezik evident: shkëputja përfundimtare e politikës nga votuesit, çka do të sjellë daljen jashtë funksionit të vetë sistemit.

Atëherë sot shtrohet pyetja: Cili është sistemi më i përshtatshëm për kushtet aktuale të vendit?

- Mazhoritar i pastër
- Proporcional i pastër
- Apo sistemi aktual Mazhoritar dhe Proporcional?

Janë pikërisht këto pikëpyetje që ulën klasën politike shqiptare në përpunimin e Kodit të Ri Zgjedhor, i cili për hir të së vërtetës duhet pranuar si më i miri që ka pasur ndonjëherë vendi.

Megjithatë është po kaq e vërtetë që Kodi i Ri mund të garantojë zgjedhje të lira dhe ndoshta edhe brenda standarteve

ndërkombëtare, por nuk garanton ndershmërinë dhe integritetin moral të tyre. Përse e them këtë?

Sepse tashmë gjithnjë e më shumë po flitet në sallonet e politikës për një "taktikë elektorale", që s'është gjë tjetër veçse përgatitja e një "Dushku të Madh".

E thënë më qartë "taktika elektorale" e zbuluar dhe e "kushtëzuar" nga Kodi i Ri dhe sistemi aktual zgjedhor, do të funksionojë e tillë: Partia më e Madhe do të mbështetet në Mazhoritar nga partitë e Vogla, ndërkohë që atyre do t'ju transferohet vota në Proporcional, duke krijuar një rritje elektorale fallco, siç ndodhi faktikisht në komunën e Dushkut në zgjedhjet e vitit 2001.

Kjo "taktikë" e cila llogjikisht do të ndiqet e kondicionuar edhe nga kampi i djathtë, do të thotë që zgjedhjet e vitit 2005 do të titullohen si "Dushku i Madh 2005".

Politikanë apo analistë politikë mund ta konsiderojnë këtë taktikë si ligjore. Por unë do të theksoja me forcë se kjo është ligjore por absolutisht e pandershme. Kjo do të sjellë zhgënjimin e radhës tek votuesit dhe thellimin e hendekut ekzistues me politikën, i cili edhe tani është i frikshëm. Duke lexuar këtë konstatim gjithkush mund të pyesë me të drejtë: Çfarë duhej bërë atëherë?

Unë personalisht mendoj se Kodit të Ri Zgjedhor i duhej bashkangjitur edhe një sistem i Ri Zgjedhor, i cili duhej të ishte Proporcional i Pastër.

Kjo do të krijonte pas zgjedhjeve një tablo të qartë për peshën reale politike të çdo Partie Politike në Shqipëri, dhe do të nxirrte jashtë politikës Parti inekzistente që edhe sot, e sidomos pas korrikut 2005 vendosin për fatin e vendit megjithëse realisht kanë 1 deri 2 % elektorat.

Proporcionali i Pastër do të zgjidhte edhe një shqetësim tjetër shumë të madh për politikën shqiptare. Infiltrimin në Parlament të elementëve të inkriminuar, të cilët direkt apo indirekt me anë të pasurive të mëdha financiare që zotërojnë nga burime të kriminalizuara, s'është çudi që të shfaqen në Parlamentin e Ri me kostumin e deputetit.

Sistemi Proporcional i Pastër do të detyronte partitë e mëdha që me anë të listave të tyre të çonin në Parlament politikanë karriere, figura politike profesionale, akademike, dhe njerëz të shquar të mendimit politik, ekonomik, ligjor apo të medias, të cilët me eksperiencën e tyre politike apo përvojën e tyre personale do të bënte që të paktën Parlamenti Shqiptar të ishte i standarteve perëndimore.

## 9. Votimi i njerëzve me paaftësi fizike

*Suzana Celami*

Zgjedhjet dhe fushata elektorale është një proces demokratik për të gjithë njerëzit. Në fund zgjedhjet kurorëzohen me hedhjen e votës në kutinë e votimit. Pra zgjedhjet janë kurorëzim i ndërgjegjes dhe vullnetit personal të çdo njeriu. Ndërgjegjësimi personal i çdo njeriu kurorëzohet me votën, e cila është universale, absolute, e pavarur, e lirë, e fshehtë dhe e padiskutueshme, nga askush, cilido qoftë ai.

Kur flasim për ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kemi parasysh të drejta të barabarta edhe për të votuar. Ndaj për këtë asnjë njeri nuk ka të drejtë të privojë tjetrin nga e drejta për të votuar.

Kanë të drejtë universale, të votojnë si gjithë të tjerët edhe njerëzit me paaftësi fizike, por jo mendore, për mendimin tim.

Natyrshëm lind pyetja: Pse? Njerëzit me paaftësi mendore që janë të shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë, të deklaruar me raport mjekësor nuk kanë të drejtë të votojnë sepse nuk kanë ndërgjegjësimit tek vetja e tyre. Pra vota e tyre automatikisht manipulohet nga të tjerët.

Kësaj kategorie njerëzish, u mohohet me të drejtë, e drejta për të votuar, sepse vota e tyre nuk është në gjendje të personifikojë e të përfaqësojë ndërgjegjen e tyre, vullnetin dhe dëshirën personale, pasi nuk ekzistojnë te këta njerëz.

Ndryshe qëndron problemi te njerëzit me paaftësi fizike, pra aftësi të kufizuara, siç janë njerëzit që nuk shikojnë, nuk dëgjojnë, që nuk ecin e që janë të gjymtuar fizikisht. Këta janë njerëz të

ndërgjegjësuar për atë që bëjnë, që mendojnë, kanë dëshirë e vullnet, por kanë aftësi të kufizuara për të vepruar.

Për këtë kategori njerëzish duhet menduar për t'u krijuar lehtësira të mjaftueshme për të votuar.

Kështu që këta njerëz edhe psikologjikisht do të ndjehen mirë dhe të papërbuzur, duke u bërë pjesë e pandarë e shoqërisë. Akoma më tepër do ta ndjenin veten të privilegjuar nëse kjo kategori njerëzish marrin pjesë edhe nëpër fushata elektorale apo dhe si vëzhgues në zgjedhje në ditën e votimit. Kjo do të ndikojë ndoshta edhe në rritjen e pjesëmarrjes së njerëzve të aftë, por që janë indiferent ndaj politikës, fushatës elektorale dhe zgjedhjeve.

Natyrshëm lind pyetja: Si do të votojnë këta njerëz, a do të mund të garantohet vota e lirë dhe e fshehtë, që përbën edhe themelin e demokracisë së një vendi?

Në pamje të parë duket pyetje e thjeshtë, por që do shumë punë, vullnet e dëshirë për të realizuar të drejtën për të votuar të këtyre njerëzve që janë dhe duhen konsideruar nga të gjithë si pjesë e pandarë e shoqërisë.

Mënyra si do të realizohet votimi duhet të përfshihet në Kodin Zgjedhor dhe duhet të zbatohet nga të gjithë me përpikmëri në të kundërt zbatohen penalitetet. Le t'i analizojmë këto kategori njerëzish.

Për njerëzit që nuk shikojnë dhe dëgjojnë ka shkolla të specializuara ku mësohet e folura dhe e shkruara me sistemin Brail, udhëzuesve të prekshëm ose audio (sistem i veçantë shkrimi e dëgjimi për të verbërit e shurdhët) të cilat përdoren gjatë ditës së votimit.

Mund të ngrihen qendra votimi vetëm për këtë kategori njerëzish ku organizimi dhe kryerja e procesit të votimit bëhet nga përfaqësuesit e Organizatës së njerëzve me paaftësi fizike. Paraprakisht duhet të dalë me statistikë numri i tyre dhe listimi i tyre të bëhet i grupuar pavarësisht nga qendra e banimit. Të dihet adresa e vendbanimit dhe të vihet në dispozicion një makinë për transportimin e tyre. Këtyre njerëzve në këtë mënyrë jo vetëm nuk u mohohet e drejta për të votuar, por do të ndjehen më mirë dhe psikologjikisht mirë, të përfillshëm e pjesë e pandarë e shoqërisë së lirë e demokratike. Për njerëzit që janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe njerëz shumë të moshuar që nuk janë në gjendje të dalin nga shtëpia duhet të evidentohen. Këtyre



duhet t'u krijohet mundësia që kutia e votimit të shkojë pranë krevatit ku janë të shtrirë. Për këtë komisioni i qendrës së votimit me një kuti të veçantë votimi duhet të lëvizë me makinë, por vetëm pasi është siguruar ruajtja me polici e qendrës së votimit dhe e kutisë së votimit. Kjo duhet të bëhet pasi të mbyllet qendra e votimit në një orë të caktuar pa u hapur kutia e votimit. Kjo bën të mundur përfshirjen e tyre në këtë proces demokratik, pra në zgjedhje.

Të gjitha këto raste që përmendëm më lartë votuesi duhet të shoqërohet për në kutinë e votimit nga dy ndihmësa, jo të njohur apo farefis të votuesit, as nga anëtarët e komisionit, pasi kjo ndikon në manipulimin e votës, por të jenë të caktuar nga KQZ, për të qëndruar gjatë gjithë procesit të votimit në qendrën e votimit. Këta ndihmësa të jenë ose përfaqësues nga dy partitë e mëdha politike ose përfaqësues nga organizata jopartiake e joqeveritare (OJQ). Them të jenë dy ndihmësa pasi vetëm kështu garantohet vota e lirë dhe e ndershme, e pandikuar, duke ndihmuar me paanësi politike tjetrin, vetëm duke respektuar vullnetin dhe dëshirën e këtyre njerëzve, duke garantuar fshehtësinë dhe pavarësinë e votës. Këta ndihmësa që caktohen nga KQZ duhet të deklarohen me shkrim për paanësi politike dhe kryerje ndershmerisht të detyrës duke ruajtur votën nga manipulimet, ndikimet politike, fshehtësia dhe përfaqësimi vetëm të vullnetit dhe dëshirës së votuesit, në të kundërt ka zgjidhje ligjore.

Mirë është që qendrat e votimit të ngrihen në katet e para për të eliminuar ngritjen e shkallëve dhe vështirësitë, duke u krijuar sa më shumë lehtësira votuesve në ditën e votimit.

Në fund të fundit kjo është demokracia, e drejta e të gjithëve për të votuar. Por të gjitha këto realizohen vetëm nga shteti. Është shteti që përcakton rregullat në Kodin Zgjedhor. Shteti është i detyruar të marrë masa për kryerjen e procesit të votimit nga të gjithë shtetasit e tij pa dallim feje, krahine, ideje, aftësie fizike...etj.

Thuhet se është e kushtueshme dhe ka kosto të lartë realizimi i votimit të njerëzve me aftësi të kufizuara. Mos të harrojmë se më e kushtueshme është t'i mohosh tjetrit të drejtën për të votuar. Më e kushtueshme për shtetin është të çenohet dhe të minohet demokracinë e vendit, pasi kjo sjell probleme të paparashikuara. Me këtë çenohet ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, e drejta

e njeriut për të votuar.

Pra ti shtet nuk ke të drejtë të mohosh votën e të mos i bindesh vullnetit, dëshirës, ndërgjegjes universale të njeriut për të votuar. Ndaj je i detyruar të marrësh masa konkrete, të krijosh kushte e mundësi për të votuar çdo individ, të numërosh votën në kushte sigurie e qetësie, jo terrori.

Është vota e lirë, e fshehtë dhe e pavarur që përcakton e përfaqëson shtetin. Vota është universi, është bota që jetojmë. Të vlerësojmë votën pasi duke e vlerësuar atë kemi vlerësuar veten tonë, familjen, lumturinë e të ardhmen e fëmijëve tanë.

# 10. Probleme të sistemit zgjedhor

*Fran Tusha*

Duke patur parasysh avantazhet dhe të metat e sistemeve zgjedhore në përgjithësi, në kushtet e vendit tonë vazhdon të mbetet i preferuar sistemi mazhoritar proporcional ose i shprehur ndryshe proporcionale me anëtarë të përzier. Ky sistem duhet të përmirësohet duke realizuar që gjysma e parlamentit të zgjidhet me metoda mazhoritare dhe gjysma tjetër nga lista proporcionale, duke i dhënë secilës pjesë nga 50 %.

Një mënyrë e tillë harmonizimi sjell avantazhin që mungesa e përpjestueshmërisë së prodhuar nga rezultati në zonat zgjedhore, të kompensohet me vendet që fitohen nga lista proporcionale. Pra partitë e vogla në kandidimin direkt në zonat zgjedhore, të kompensohet me vendet që fitohen nga lista proporcionale. Pra partitë e vogla në kandidimin direkt në zonat zgjedhore, mund të mos fitojnë asnjë vend në parlament, ndërsa me përqindjet e votave të fituara nga proporcionali kompensojnë dhe realizojnë një ose disa vende.

Avantazh tjetër shumë i rëndësishëm është përfaqësimi gjeografik, një kërkesë tepër e domosdoshme për të kënaqur interesat e votuesve. Nga ana tjetër rritja dhe vlerësimi i elementit proporcional shoqërohet me disa efekte pozitive.

Pasi është bërë zgjedhja e kandidatëve më potencial për të fituar me kandidimin direkt në zonat zgjedhore, në dorën e forcave politike mbetet analiza dhe plotësimi i gjysmës tjetër të parlamentit me hartimin e listave proporcionale. Kjo analizë po të bëhet me kujdes nga secila parti, eliminon një seri difektesh të

ndodhura në legjislaturat e mëparshme.

Plotësimi i listës shumëemërore i studiuar e me përgjegjësi mund të realizojë të gjitha profilet e nevojshme për jetën parlamentare, duke zgjedhur njerëzit më të aftë, më të denjë e të përkushtuar. Bën të mundur rritjen e pjesëmarrjes së grave në qeverisje e në të gjitha sferat e jetës politike të vendit. Harmonizon përbërjen e të gjitha grupmoshave duke futur edhe elementë të rinj, me frymë të re, të arsimuar në vende perëndimore.

Në praktikën e deritanishme zgjedhore janë vërtetuar difekte të rëndësishme të cilat kanë zbehur pjesëmarrjen në qeverisje të zonave, duke grumbulluar shumë deputetë në disa zona të tjera.

Lëvizja e popullsisë drejt qyteteve për një jetë më të mirë ka bërë që ajo të pakësohet në zonat rurale. Por madhësia gjeografike, problemet infrastrukturore e varfëria mbeten tepër shqetësuese, të pamëshuar e të pazvogëluara. Ndërsa në qytete të mëdha si Tirana problemet e infrastrukturës së gjithanshme janë pothuajse të zgjidhura plotësisht dhe madhësia gjeografike e zonave zgjedhore e vogël dhe e papërfillshme.

Prandaj mendojmë se në politikën e ndarjes së zonave zgjedhore, duhet të kihet parasysh jo vetëm numri i popullsisë, por edhe madhësia gjeografike, problemet infrastrukturore dhe varfëria. Kështu në zonën veriore e verilindore të vendit dhe në përgjithësi në zonat rurale me prapambetje të theksuar një zonë zgjedhore duhet të ketë jo më shumë se 10-15 mijë zgjedhës.

Ndërsa në qytetin e Tiranës dhe në qytete të tjera të vendit me infrastrukturë të zhvilluar krahasuar me zonat rurale, atje ku zgjedhësit e nevojshëm për një zonë zgjedhore gjenden brenda një blloku a rrugë kërkohet që numri i zgjedhësve të jetë jo më pak se 35-40 mijë. Vetëm kështu mund të përafrohet puna dhe aktiviteti përfaqësues i deputetëve.

Problem tjetër që duhet të kihet parasysh nga forcat politike është që edhe në sistemin proporcional të bëhet njëfarë ballancimi deputetësh ndërmjet territoreve të vendit. Psh në këtë legjislaturë që po mbaron në zonën veriore nuk ka pothuajse asnjë deputet nga proporcionali. Pra si për të gjithë problemet edhe në këtë fushë veriu vazhdon të shihet me syrin e njerësisë. Dhe për çudi, ndoshta rastësisht janë bashkuar në një veprim të dyja forcat kryesore politike.

Për partitë e vogla vazhdon të mbetet shqetësues pragu

elektoral. Ai duhet të llogaritet me dashamirësi deri në atë masë sa që nga mbetjet të mos përfitojnë të mëdhenjtë. Për shembull, duke supozuar se në votime marrin pjesë 2 milion njerëz, për 70 deputetë të proporcionalit, i takon mesatarisht 30 mijë për 1 deputet. Ky raport rezulton afërsisht me 1.5% të votave proporcionale për 1 deputet. Pra edhe pragu elektoral nuk duhet të jetë më i lartë se 1.5%. por nga forcat e vogla politike mund të ketë shumë prej tyre që arrijnë rezultatin nën 1.5%. Duke i mbledhur së bashku mbetjet ato mund të realizojnë dy apo më shumë deputetë. Të gjithë ato që fitojnë nën 1.5% duke filluar nga më i larti, duhet të kenë të drejtën e përfitimit të mbetjeve deri sa ato të mbarohen.

Realizimi i këtyre kërkesave bën të mundur që të zbuten efektet monopolizuese të të dy forcave kryesore politike, duke realizuar qeverisje koalicioni dhe pjesëmarrje aktive e të plotë të partive të vogla në jetën politike e qeverisëse.

# Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)

Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare (National Democratic Institute for International Affairs), Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët Shqipëri), dhe Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), janë Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA). Sfida përpara Shqipërisë është të adresojë korrupsionin dhe të krijojë një kulturë politike të hapur, pjesëmarrëse dhe transparente. Për ta përmbushur këtë, qytetarët duhet të organizohen për të devijuar fokusin e qeveritarëve nga përfitimet vetjake drejt një shërbimi më të mirë ndaj interesit publik. Konsorciumi DGA, i bazuar në eksperiencën e tij në Shqipëri dhe e gatshme me ide të reja, punon me kolegë shqiptarë dhe ndërkombëtarë për arritjen e këtij qëllimi.

Me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Konsorciumi DGA ndihmon grupet civile t'i hapin dyert qeverive lokale nëpërmjet organizimit avokacisë dhe përpejkjeve vëzhguese, bordeve organizuese qytetare dhe takimeve publike. OJF-të në nivel kombëtar grupohen bashkë dhe krijojnë mekanizma të fortë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ. Gazetarët rrisin standardet e tyre profesionale dhe u japin qytetarëve informacionin që ata duan për të ndarë opinionet dhe u japin zë ideve të tyre. Partitë politike janë më përgjegjëse ndaj publikut, shtrirjes së qytetarëve, demokratizimit të veprimtarive të brendshme dhe nxit breza të rinj udhëheqës. Zgjedhjet shqiptare do të bëhen më demokratike kur me qindra

qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara për të monitoruar procesin zgjedhor. Në të gjithë këto aktivitete, gratë janë pjesëmarrëse të dalluara, kështu që ato mund të luajnë një rol në rritje, të dukshëm dhe të rëndësishëm në jetën publike.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Politikani i Ri : fletore e Akademisë për udhëheqësi  
dhe reformë politike/ përg. National Democratic Institute  
for International Affairs / Dan Redford, etj. - . -

Tiranë : Pegi, 2005 .

V.1, 39 f. ; 20.7

ISBN 99943-705-3-7

324(496.5)

342.8(496.5)